

Classic sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7-20

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Classic shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Classic shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijmësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

30 mars 2017


Luan Kamberi
Auditor Ligjor



Classic shpk
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31dhjetor2016	31dhjetor2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	4,866,651	14,647,428
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	249,376,004	110,439,448
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	212,742,606	210,023,473
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	82,732,243	1,185,770
Inventari	8	69,361,519	69,171,570
Parapagime per furnizime	9	229,343,961	1,775,625
Total aktive afatshkurtra		848,422,984	407,243,314
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	486,704,869	491,121,014
Total aktive afatgjata		486,704,869	491,121,014
Total aktive		1,335,127,853	898,364,328
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	470,293,140	596,774,151
Llogari të pagueshme tregtare	12	185,675,437	75,213,586
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	79,201,154	80,518,708
Detyrime tatimore	14	2,576,899	2,583,007
Të ardhura të shtyra	15	371,540,670	-
Të tjera detyrime		10,000	-
Total detyrime afatshkurtra		1,109,297,300	755,089,452
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	16	189,650,021	102,371,748
Të ardhura te shtyra	17	-	15,218,436
Të tjera detyrime	18	26,804,002	13,897,350
Total detyrime afatgjata		216,454,023	131,487,534
Totali i detyrimeve		1,325,751,323	886,576,986
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	19	88,000,000	88,000,000
Rezerva statutore		166,500	166,500
Rezerva ligjore		13,500	13,500
Fitime të mbartura		(76,392,658)	(76,436,174)
Fitimi i ushtrimit		(2,410,812)	43,516
Totali kapitali		9,376,530	11,787,342
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,335,127,853	898,364,328

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Classic shpk
(Vlerat janë në Lek)
Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	1,559,567,404	753,471,792
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	10,031,910	10,027,930
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(1,497,168,650)	(662,076,119)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	22	(1,470,211,819)	(642,869,791)
2) Të tjera shpenzime	23	(26,956,831)	(19,206,328)
Shpenzime të personelit	24	(30,454,164)	(32,678,130)
1) Paga dhe shpërblime		(26,310,219)	(28,148,050)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(4,143,945)	(4,530,080)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(24,051,647)	(34,555,263)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(1,901,190)	(993,713)
Shpenzime financiare		(15,484,527)	(33,045,046)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme	26	(24,658,754)	(43,902,729)
2) Shpenzime të tjera financiare	27	9,174,227	10,857,683
Fitimi/humbja para tatimit		539,136	151,451
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(2,949,948)	(107,935)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	28	(2,949,948)	(107,935)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(2,410,812)	43,516
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		(2,410,812)	43,516

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2015	88,000,000	13,500	166,500	(62,761,684)	(13,674,490)	11,743,826
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin: Transferim në fitim/humbje të mbartura				(13,674,490)	43,516 13,674,490	43,516 -
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	88,000,000	13,500	166,500	(76,436,174)	43,516	11,787,342
Fitimi / Humbja e vitit				(43,516)	(2,367,296)	(2,410,812)
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	88,000,000	13,500	166,500	(76,392,658)	2,410,812	9,376,530

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Classic shpk më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Artan Qesko
Administrator

Znj. Mimoza Palushi
Drejtuese e Financës

Classic shpk
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(2,410,812)	43,516
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(7,224,877)	(8,396,106)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	24,051,647	34,555,263
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata material		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata material	(8,791,343)	(6,182,189)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(450,770,498)	228,533,664
Rënie/(rritje) në inventarë	(189,949)	20,893,624
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	465,470,424	(105,095,209)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	20,134,592	164,352,563
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(49,867,125)	(19,633,668)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	39,022,966	40,655,217
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(10,844,159)	21,021,549
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara		
Pagesa e huave	(26,296,087)	(182,005,797)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(26,296,087)	(182,005,797)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(17,005,654)	3,368,315
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	14,647,428	2,883,007
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	7,224,877	8,396,106
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4,866,651	14,647,428

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Classic" shpk është krijuar në korrik 1999, me vendim gjykatë nr. 21604. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Shoqëria ka NIPT J91909004J.

Shoqëria është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- Z. Agron Papuli, zotëron 66.67% të kuotave të kapitalit të shoqërisë

- Z. Artan Qesko, zotëron 33.33% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 88,000,000 Lek, i ndarë në 100 pjesë me vlerë 880,000 Lek secila. Administrator i shoqërisë është Z. Artan Qesko.

Selia e shoqërisë është në Autostradën Tiranë-Durrës, km 1, rruga dytësore, Godina Nr. 8, Kashar, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie, si përfaqësues ekskluziv i firmës "Volkswagen A.G" është tregtimi dhe riparimi i automjeteve të grupit Volkswagen, organizimi i panaireve dhe ekspozitave për paraqitjen e automjeteve, dhënia e automjeteve me qira, etj.

Në 31 dhjetor 2016 shoqëria ka 35 punonjës. (2015: 38).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç'regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarjeje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit, e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare, siç kërkohej nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/Lek	135.23	137.28
Usd/ Lek	128.17	125.79

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes, duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, për afrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar, sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme, duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime, të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e ç'montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlerë e mbetur	5%
Makineri e Pajisje	Vlerë e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Zyre	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Kompjuterike	Vlerë e mbetur	25%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20%

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare) të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë, me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor, të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime, për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31dhjetor2016	31dhjetor2015
Depozita në bankë e llogari të tjera	4,850,966	14,517,247
Vlera në arkë	15,685	130,181
	4,866,651	14,647,428

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31dhjetor2016	31dhjetor2015
Klientë për shitje makinash	175,378,888	27,634,770
Klientë për shitje pjesësh	27,528,579	33,483,676
Klientë Leasing Qira	45,691,915	48,519,567
Të tjera	776,622	801,435
	249,376,004	110,439,448

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	154,662,745	154,034,606
Hua të dhëna palëve të lidhura	58,079,861	55,988,867
	212,742,606	210,023,473

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Tatim fitimi i mbipaguar	810,149	330,115
Të tjera të arkëtueshme	81,922,094	855,655
	82,732,243	1,185,770

Classic shpk**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në Lek)***8. Inventari**

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Makina	12,363,385	10,448,842
Pjesë këmbimi	56,998,134	58,722,728
	<u>69,361,519</u>	<u>69,171,570</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhshme

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	1,937,578	1,775,625
Parapagime per mallra eksporti	227,406,383	-
	<u>229,343,961</u>	<u>1,775,625</u>

Classic shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje informatike	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	370,000,000	51,084,334	336,728,964	19,306,730	10,152,371	10,668,855	797,941,254
Shtesa	15,000,000	71,666	4,293,800	-	46,163	222,039	19,633,668
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(84,213,387)	(3,192,163)	-	(2,411,943)	(89,817,493)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	385,000,000	51,156,000	256,809,377	16,114,567	10,198,534	8,478,951	727,757,429
Shtesa	20,000,000	31,358	29,133,040	99,834	543,213	59,680	49,867,125
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(67,797,094)	-	-	-	(67,797,094)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	405,000,000	51,187,358	218,145,323	16,214,401	10,741,747	8,538,631	709,827,460

Amortizim i akumuluar

Gjendja më 1 janar 2015	20,486,250	41,144,763	165,515,531	15,416,216	8,364,633	6,498,224	257,425,617
Amortizimi i vitit	-	1,701,738	31,309,029	656,589	407,130	480,777	34,555,263
Rimarrje e amortizimit per AAM e shitura	-	-	(50,682,951)	(2,818,887)	-	(1,842,627)	(55,344,465)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	20,486,250	42,846,501	146,141,609	13,253,918	8,771,763	5,136,374	236,636,415
Amortizimi i vitit	-	1,368,721	21,511,296	491,955	333,185	346,490	24,051,647
Rimarrje e amortizimit per AAM e shitura	-	-	(37,565,471)	-	-	-	(37,565,471)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	20,486,250	44,215,222	130,087,434	13,745,873	9,104,948	5,482,864	223,122,591

Vlera neto kontabël

Gjendja më 31 dhjetor 2015	364,513,750	8,309,499	110,667,768	2,860,649	1,426,771	3,342,577	491,121,014
Gjendja më 31 dhjetor 2016	384,513,750	6,972,136	88,057,889	2,468,528	1,636,799	3,055,767	486,704,869

11. Hua afatshkurtër

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Huamarrje Afatshkurtra nga bankat	377,434,058	555,545,940
Pjesë afatshkurtër e huasë afatgjatë	92,859,082	41,228,212
	<u>470,293,140</u>	<u>596,774,152</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë për blerje mallrash dhe shërbimesh	24,448,566	75,213,586
Parapagime nga furnitorët	161,226,871	-
	<u>185,675,437</u>	<u>75,213,586</u>

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	79,201,154	80,518,708
	<u>79,201,154</u>	<u>80,518,708</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Sigurime shoqërore e shëndetësore	1,023,308	754,089
TVSH	1,553,591	1,828,918
	<u>2,576,899</u>	<u>2,583,007</u>

15. Të ardhurat e shtyra

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paradhenie të marra për eksporte	371,540,670	-
	<u>371,540,670</u>	<u>-</u>

16. Hua afatgjata

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Huamarrje nga bankat	189,650,021	102,371,748
	<u>189,650,021</u>	<u>102,371,748</u>

17. Të ardhura të shtyra

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të ardhura të periudhave të ardhshme	-	15,218,435
	-	15,218,435

18. Të tjera detyrime

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të tjera hua afatgjata të dhëna të tretëve	26,804,002	13,897,351
	26,804,002	13,897,351

19. Kapitali

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Vlera	Nr i kuotave	Vlera	Nr i kuotave
Z. Agron Papuli	58,669,600	66.67	58,669,600	66.67
Z. Artan Qesko	29,330,400	33.33	29,330,400	33.33
Totali	88,000,000	100.00	88,000,000	100.00

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Nga shitja e makinave të eksport	1,294,878,939	-
Nga shitja e makinave brenda vendit	124,560,035	575,806,581
Nga shitja e pjesëve të këmbimit	58,835,586	75,094,899
Nga makinat me qira e Leasing	62,442,891	76,848,240
Nga riparime dhe shërbime	18,849,953	25,722,072
	1,559,567,404	753,471,792

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Qarkullim i tatueshëm	1,584,612,504
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2015	15,218,435
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,599,830,939
Shifra sipas Kontabilitetit	1,574,047,015
Të ardhurat nga Shitja e AAM të paraqitura Neto tek të ardhura të tjera	39,022,966
Fitime nga kurset e këmbimit	(14,479,609)
Të ardhura të Tjera	1,240,567
Sipas Kontabilitetit:	1,599,830,939
Diferenca	-

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Rezultati nga shitja e AAM-ve*	8,791,343	6,182,189
Të ardhura të tjera	1,240,567	3,845,741
	10,031,910	10,027,930
<i>Rezultati nga shitja e AAM-ve:</i>		
Nga shitja e AAM-ve	39,022,966	40,655,217
Kosto e AAM-ve të shitura	(30,231,623)	(34,473,028)
	8,791,343	6,182,189

22. Lënda e parë, shërbime dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit, të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime makina për eksport	1,231,352,207	
Mallra makina	115,818,915	497,725,851
Mallra dhe pjesë këmbimi	51,875,838	81,562,385
Qira ambjenti dhe makina	40,826,668	39,119,745
Materiale dhe riparimet të ndryshme	10,915,153	13,025,269
Karburant për makina e shitura dhe gjenerator	1,312,797	1,234,435
Siguracione dhe shpenzime për targat e makinave	5,242,654	5,858,338
Shpenzime të shërbimeve doganore	1,349,735	225,823
Shpenzime transporti	9,512,680	2,589,331
Riparime, pjesë makina garanci dhe brenda çmimit	257,432	1,240,786
Tarifa doganore	1,747,740	287,828
	1,470,211,819	642,869,791

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Taksa vendore	2,154,024	1,095,376
Shpenzime të ndryshme të pazbritshme	1,610,567	965,517
Konsulencë juridike e ekonomike	1,631,204	1,493,006
Kancelari e noterizime	751,539	1,064,465
Energji elektrike e ujë	1,756,850	2,302,341
Roje civile	1,000,000	1,520,000
Shpenzime telefoni e postare	1,609,131	2,966,392
Udhëtime e dieta	891,998	453,520
Të tjera	13,463,603	6,665,513
Shërbime bankare	1,285,610	442,677
Materiale pastrimi	206,517	237,521
Reklama	595,788	-
	26,956,831	19,206,328

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime page	26,310,219	28,148,050
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shendetësore	4,143,945	4,530,080
	<u>30,454,164</u>	<u>32,678,130</u>

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Gjoha dhe penalitete	1,901,190	993,713
	<u>1,901,190</u>	<u>993,713</u>

26. Shpenzime interesi

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga interest	292,100	408,649
Shpenzime interesi	(22,253,136)	(42,510,704)
Komisione	(2,697,718)	(1,800,674)
	<u>(24,658,754)</u>	<u>(43,902,729)</u>

27. Shpenzime të tjera financiare

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga diferencat e kurseve të këmbimit	14,479,609	18,658,059
Shpenzime nga diferencat e kurseve të këmbimit	(5,305,382)	(7,800,376)
	<u>9,174,227</u>	<u>10,857,683</u>

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<i>Fitimi para tatimit</i>	539,136	151,451
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	19,127,181	11,677,995
Shpenzime pritje & percjellje	-	-
Shpenzime udhëtimi	891,998	453,520
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	1,901,190	993,713
Shpenzime pa dokumenta të rregullta tatimor	-	-
Shpenzime të tjera	14,653,846	5,260,257
Interesa të panjohura	1,680,147	4,970,505
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	19,666,317	11,829,446
Humbje fiskale e mbartur	-	(11,109,877)
Ulje e humbjes së mbartur sipas akt kontrollit	19,666,317	-
Fitimi i tatueshëm	539,136	719,569
Tatim fitimi @15%	2,949,948	107,935
	(2,410,812)	43,516

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.